

VENDIM
Nr.873, datë 3.11.2010

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT E TË PËRFUNDIMIT TË REGJISTRIMIT TË
PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE JOBUIJQËSORE, SI DHE TË AFATIT
TË PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE STATISTIKORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.10 202, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore”, me propozimin e Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e datës 8 nëntor 2010 për fillimin e regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore dhe të datës 6 dhjetor 2010 për përfundimin e këtij regjistrimi.
 2. Caktimin e datës 15 dhjetor 2011, si afat për publikimin e të dhënave statistikore.
 3. Ngarkohet Instituti i Statistikave (INSTAT) për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha